



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 20
Prishtinë, më 23 qershor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë – Shqyrtimi i dytë të Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetes Safete Hadergjonaj, i cili u miratua.

Kryetari konstatoi se Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 16 qershor 2011,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legislative,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjendjen civile,
10. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor,
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Donika Kadaç-Bujupi, Berat Buzhala, Amir Ahmeti, Teuta Sahatqija, Alma Lama, Blerta Deliu-Kodra, Afërdita Berisha-Shaqiri, Glauk Konjufca dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, nuk e parashtoi pyetjen në mungesë të zv.kryeministres Mimoza Kusari-Lila.

Deputeti Goran Marinković, nuk ishte i pranishëm në sallë për ta parashtruar pyetjen për ministrin Besim Beqaj.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 16 qershor 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes plenare, të datës 16 qershor 2011.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legislative

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për nisma legislative.

Zv.kryeministri **Bujar Bukoshi**, tha se nevoja për nxjerrjen e Ligjit për nisma legislative ekziston, ngase deri më tani kjo fushë nuk është rregulluar me ndonjë ligj adekuat, ndërsa ajo garantohet me Kushtetutë. Qeveria mbi këtë bazë ka propozuar këtë Projektligj për ta rregulluar këtë fushe me legjislacionin përkatës, me qëllim që të mundësohet pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në procesin legjislativ.

Më tutje, zv. kryeministri potencoi se ky Projektligj parasheh rregullat dhe procedurat për nismat legislative nga autoritetet relevante, duke përfshirë Presidentin e Republikës së Kosovës, deputetët e Kuvendit, Qeverinë dhe së paku 10 mijë qytetarë me të drejtë vote. Autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji do të jetë Zyra e kryeministrit, ndërsa projektligji është i harmonizuar me legjislacionin evropian, theksoi zv. kryeministri Bukoshi.

Në fund, ai kërkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratojnë, në parim, Projektligjin për nisma legislative.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për nisma legislative.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Myfera Shinik, si dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për nisma legislative.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për shërbimet e sigurisë private

Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e arsyetoi zv.kryetari i parë i këtij komisioni, deputeti Rexhep Selimi.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Selimi, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,

Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për shërbimet e sigurisë private.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për eficiencën e energjisë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 74,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për eficiencën e energjisë.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjendjen civile

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për gjendjen civile.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për gjendjen civile.

10. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor

Kryetari ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projekt-planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor.

Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, tha se komisioni ka shqyrtuar Propozim-planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Propozim-planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim-planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale

Në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi tha se komisioni që ai drejton ka shqyrtuar Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e këtij propozimi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	58
Kundër-----	19,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Ruzhdi Jashari, emërohet mbikëqyrës kryesor shtetëror i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me mandat pesë (5) vjeçar.

II. Mbikëqyrës shtetëror të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, emërohen:

1. Ramadan Qehaja,
2. Mentor Hoxhaj,
3. Bekim Demiri,
4. Aleksandër Spasiq.

Mandati i të emëruarve nga pika nr. **II.** e këtij Vendimi është pesë (5) vjet.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadergjonaj.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Hadergjonaj, kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15A, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 7.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,

Kundër----- 5,

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:27 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.